



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Nr. ref. 01/05

Prishtinë, 23.03.2020

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS), në mbështetje të neneve 10, 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 8 pikat 20, 30 e 31 të Rregullores (QRK) nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe vendimeve nr. 01/09 të 13 marsit 2020 dhe nr. 1/11 të 15 marsit 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me masat ndaj pandemisë COVID-19 dhe emergjencës së ndërlidhur të shëndetit publik, bazuar tutje në Ligjin nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, i ndryshuar, si dhe në urdhëresat e lëshuara nga MEPTINIS nr. 01/01 e 12 marsit 2020, nr. 01/02 e 17 marsit 2020, nr. 01/03 e 17 marsit 2020, e plotësuar me urdhëresën nr. 01/04 të 20 marsit 2020; dhe duke pasur parasysh kërkesat e Planit Kombëtar të Reagimit dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, nxjerr këtë:

URDHËRESË

**për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë
emergjencës së shëndetit publik (23.03.2020)**

1. Urdhërohen të gjithë operatorët ekonomikë:

- 1.1. të zbatojnë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/09 të 13 marsit 2020 dhe nr. 1/11 të 15 marsit 2020, lidhur me masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj pandemisë COVID-19 dhe emergjencës së ndërlidhur të shëndetit publik;
- 1.2. të veprojnë në përputhje me këtë urdhëresë, me urdhëresat nr. 01/01 të 12 marsit 2020, nr. 01/02 të 17 marsit 2020, nr. 01/03 të 17 marsit 2020, të plotësuar dhe ndryshuar me urdhëresën nr. 01/04 të 20 marsit 2020; dhe
- 1.3. me vendime dhe urdhëresa të tjera që mund të nxjerrin Qeveria dhe Ministria lidhur me emergjencën e shëndetit publik.

- 7.4. Brenda lokaleve të tyre nuk lejohet të qëndrojë asnjë person, përveç personelit. Ambientet, personeli dhe mjetet e transportit të angazhuara për shpërndarjen e porosive tek klientët, duhet të trajtohen me masa rigorozë të higjienës, sipas pikës 2. Gjatë përgatitjes e dorëzimit të produkteve, duhet me rigorozitet të respektohen masat e distancës shoqërore e shmangies së kontaktit.
8. Shitoret, marketet ushqimore, furrat e bukës, barnatoret mjekësore dhe bujqësore, pikat e karburantit, autolarjet, shërbimet komunale e financiare e veprimtari të tjera që lejohen të punojnë, sipas listës me kode "NACE" (siç janë të regjistruara në ARBK), u nënshtrohen kushteve si vijon:
- 8.1. Duhet t'i mbyllin kënd-kafiteritë e shërbimin e pijeve e ushqimeve me marrje me vete (take-away). Largohen edhe makinat vetëshërbyese (Vending machine), por lejohet shpërndarja e produkteve/shërbimeve me porosi (delivery).
- 8.2. Tek karburantet e auto-larjet, lejohet të punojë marketi ushqimor dhe dyqani i lubrifikantëve e aksesoreve, por mbyllet veprimtaria gastronomike (pije e ushqime) në kuadër të tyre e me marrje me vete (Take-away). Largohen edhe makinat vetëshërbyese (Vending machine). Por lejohet shpërndarja e produkteve/shërbimeve me porosi (delivery).
9. Ndalohet shërbimi i ushqimeve e pijeve brenda menzave të punëtorëve. Punëdhënësi, duhet të siguroj shpërndarje të ushqimeve të përshtatshme për t'u konsumuar në vend punishte/hapësirën e punës.
10. Ndalohen të gjitha operacionet e gastronomisë në hotele. Mysafirët mund të shërbehen me ushqim të përshtatshëm për konsumim në dhomë. Hoteli duhet të sigurojë që ka të dhënat e sakta të mysafirëve, duke përfshirë shtetin prej nga kanë ardhur. Hoteli duhet të ndërmarrë masa në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.
11. Operatorët e posaçëm që merren me shërbime komunale, financiare, elektronike dhe postare mund të ofrojnë shërbime me orar dhe staf të organizuar në masë të arsyeshme, sipas masave në fuqi për emergjencën e shëndetit publik (të cekura në pikën 1).
12. Ndalohet shpërndarja e materialeve promocionale të shtypura, siç janë fletushkat, kuponat, katalogët e të tjera.
13. Ndalohet shitja ambulante/mobile e ushqimeve e pijeve dhe vendosja e makinave vetëshërbyese (vending-machine) në vende publike e brenda ambienteve të operatorëve të ndryshëm ekonomikë⁵.
14. Prodhuesit, përpunuesit, ndërtimtarët⁶ dhe veprimtaritë e tjera tregtare dhe shërbyese (të papërmendura në këtë urdhëresë) mund të ushtrojnë veprimtaritë

⁵ Kjo si rezultat i turmave të krijuara tek këta operatorë

⁶ Të sigurohet mbajtja e distancës shoqërore e shmangia e kontaktit dhe masat e tjera sipas MSH dhe IKShP, si gjatë transportit të punëtorëve, ashtu edhe gjatë punës.



2. Çdo operator ekonomik që lejohet të veprojë sipas kësaj urdhërese duhet të marrë këto masa higjienike e parandaluese:
 - 2.1. të dezinfektojë dhe të ajrosë rregullisht lokalin dhe hapësirën e punës;
 - 2.2. të pajisë punëtorët me mjete mbrojtëse personale, sipas udhëzimeve të fundit të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike (IKSHP);
 - 2.3. të marrë masa për distancën shoqërore dhe shmangien e kontaktit, edhe për punonjësit edhe për klientët, sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike (IKSHP),
 - 2.4. të shfrytëzojë sa më shumë kanalet elektronike për të ushtruar veprimtarinë, duke përfshirë shitjen e mallrave dhe shërbimeve, si dhe pagesat,¹ dhe
 - 2.5. të marrë masat e tjera të nevojshme për të zbatuar vendimet e Qeverisë lidhur me emergjencën shëndetësore.
3. Mbyllen qendrat tregtare (që operojnë në mjedise të hapura dhe të mbyllura, përfshirë këtu edhe çarshitë²), përveç barnatoreve (mjekësore e bujqësore) dhe shitoreve ushqimore në këto qendra tregtare.
4. Mbyllet tregtia me pakicë e tekstitit dhe produkteve të ngjashme, hekrarive dhe gjësendeve metalike e të ngjashme, si dhe libraritë. Këndet shitëse të këtyre produkteve në markete të mëdha duhet të demobilizohen.
5. Mbyllen shërbimet e parukerisë, trajtime estetike, palestra, e të ngjashme sipas listës me kode "NACE"³ (siç janë të regjistruara në ARBK), të bashkëngjitur në këtë Urdhëresë.
6. Mbyllen edhe veprimtaritë tjera tregtare/shërbyese si në listën me kode "NACE" (siç janë të regjistruara në ARBK), të bashkëngjitur në këtë Urdhëresë.
7. Mbyllen veprimtaritë gastronomike: baret, pabet, kafiteritë, gjellëtoret, qebapto-ret, restorantet, e veprimtari tjera për shërbim të pijeve e ushqimeve, *për shërbim të klientëve vizitues (walk-in clients)*. Këta operatorë u nënshtrohen kushteve si vijon:
 - 7.1. Duhet t'i demobilizojnë tavolinat e karriget që përdoren për shërbim brenda lokaleve të tyre dhe duhet ti mbyllin dyert për klientët vizitues.
 - 7.2. Nuk u lejohet shërbimi *marrje me vete (take-away)*⁴.
 - 7.3. Por u lejohet që produktet/shërbimet t'i shpërndajnë *me porosi (delivery)*.

¹ Përdorimi i parasë së gatshme sjell rrezik për përhapjen e pandemisë COVID-19

² Kjo si rezultat i turmave të krijuara nëpër tregje dhe çarshi

³ Në listën e veprimtarive me kode NACE qartësohet se cilat veprimtari ekonomike lejohen të punojnë dhe cilat veprimtari ekonomike nuk lejohen të punojnë.

⁴ Kjo si rezultat i turmave të krijuara tek këta operatorë



e tyre sipas listës me kode NACE, duke marrë masat nga pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.5.

15. Veprimtaritë ekonomike do t'i nënshtrohen kufizimeve në kohë dhe shtrirje sipas vendimeve të ardhshme të Qeverisë me masat shtesë, në lidhje me emergjencën e shëndetit publike.
16. Detyrohen inspektorët e tregut dhe inspektorët e punës në tërë Republikën e Kosovës të shqyrtojnë me përparësi rastet që lidhen me zbatimin e vendimeve dhe urdhëresave të cekura në pikën 1.
17. Plotësohet dhe ndryshohet Urdhëresa nr. 01/04 e 20 marsit 2020.
18. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Rozeta HAJDARI,

Ministre

U dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit
- zëvendëskryeministrave
- të gjithë ministrave (ministrive)
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Inspektoratit i Tregut
- Inspektoratit i Punës
- inspektorateve komunale
- Departamentit Ligjor
- Arkivit



QEVERIA E KOSOVËS - Vlada Republike Kosovo - GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Num. Orig. 01
Num. Orig. 06
Num. Orig. 1598
Data: 23.04.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

**SHTESË: KLASIFIKIMI I VEPRIMTARIVE EKONOMIKE, SIPAS KODEVE NACE*,
NË LIDHJE ME URDHËRESËN E MEPTINIS, TË DT. 23 MARS 2020**

KODI NACE Rv. 2	VEPRIMTARIA	LEJOHET	VËREJTJE
01	Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to	PO	
02	Pylltaria dhe prerja e drunjve	PO	
03	Peshkimi dhe Akua-kultura	PO	
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	PO	
06	Nxjerrja e naftës së papërpunuar dhe gazit natyror	PO	
07	Nxjerrja e xehes së metalit	PO	
08	Xehedorët dhe guroret tjera	PO	
09	Veprimtaritë e shërbimeve mbështetëse të xeheroreve	PO	
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	PO	
11	Prodhimi i pijeve	PO	
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	PO	
13	Prodhimi i tekstilit	PO	
14	Prodhimi i veshjeve	PO	

PK

15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	PO	
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	PO	Sqarim: ndërsa kategoria 31 i liston prodhimet e mobiljeve.
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	PO	
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	PO	.
19	Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	PO	
20	Prodhimi i produkteve kimike	PO	
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	PO	
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	PO	
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike	PO	
24	Prodhimi i metaleve	PO	
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve	PO	
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	PO	
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	PO	
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	PO	
29	Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove	PO	
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	PO	
31	Prodhimi i mobilie	PO	
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	PO	
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	PO	
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar	PO	



36	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	PO	
37	Kanalizimi	PO	
38	Veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve	PO	
39	Veprimtaritë e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave	PO	
41	Ndërtimi i ndërtesave	PO	
42	Punimet inxhinierike	PO	
43	Veprimtaritë e ndërtimit të specializuar	PO	
45	Tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	JO	NDALOHEN të gjitha veprimtaritë e kësaj kategorie, me përjashtim të n/kategorive: 45.2
45.2	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	PO	
46	Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave	PO	LEJOHEN të gjitha veprimtaritë e kësaj kategorie, me përjashtim të n/kategorive: 46.19
46.19	Veprimtaritë e ndërmjetësimit për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash	JO	
47	Tregtia (jo-ushqimore) me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave	JO	NDALOHEN të gjitha veprimtaritë e kësaj kategorie, me përjashtim të n/kategorive: 47.73, 47.74, 47.91
47.73	Tregtia me pakice e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore, farmaci)	PO	
47.74	Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara	PO	
47.91	Tregtia me pakicë me porosi nga shtëpia nëpërmjet postës ose internetit	PO	Me përjashtim të blerjes së mallrave nga vendet e prekura!
49	Transporti tokësor dhe transporti përmes tubacioneve	JO	LEJOHET transporti i mallërave (brenda dhe nga jashtë vendit, zingjiri i furnizimit), LEJOHET bartja e punëtoreve. Shiko vendimet e Min. Infrastrukturës e Ambientit në lidhje me emergjencën e shëndetit publik (COVID-19) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

50	Transporti ujor	JO	
51	Transporti ajror	JO	<u>PËRVEÇ</u> fluturimeve të vecanta, sipas <u>Vendimit të Qeverisë (per marrjen e masave shtese pas konfirmimit te rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19), pika 5, të dt. 13.03.2020.</u>
52	Magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport	PO	
53	Veprimtaritë postare dhe të ndërlidhjes postare	PO	SHIKO EDHE Urdhëresën nga MEPTINIS për Komunikime Elektronike e Postare, dt. 17 mars 2020.
55	Akomodimi	PO	SHIKO EDHE Urdhëresën nga MEPTINIS, <u>dt. 23 mars 2020</u> , pika 10.
56	Veprimtaritë shërbyese të ushqimit dhe pijeve	JO	<u>Urdhëresa dt. 23 mars 2020, nga MEPTINIS.</u>
56.2	Furnizimi me ushqim me porosi për raste dhe shërbime të tjera ushqimore	PO	"Catering" dhe "Delivery".
56.21	Furnizimi me ushqim me porosi për raste	PO	"Catering" dhe "Delivery".
58	Veprimtaritë botuese	JO	Sqarim: vetëm "online" dhe kategoria 58.2. Ndalohe shpërndarja e shitja e botimeve në formë të printuar.
58.2	Publikimi i softuerëve	PO	
59	Prodhimi i filmave, videove dhe programeve televizive, incizim i zërit dhe veprimtaritë e publikimit të muzikës	PO	
60	Veprimtaritë programore dhe të transmetimit	PO	P.sh. RTK, Radio-TV tjera, KTTN, e operatorë tjerë që e operojnë e mirëmbajnë sistemin e prodhimit dhe transmetimit të përmbajtjeve radio-televizive.
61	Telekomunikimi (komunikimeve elektronike)	PO	Sqarim: operatorët e shërbimeve të komunikimit elektronike, duhet që pagesat e përkrahjen në masë sa më të madhe ti kalojnë On-line, apo nëpërmjet institucioneve financiare. "Back-office" kërkohet shpërhimisht të punoj, konform urdhëresës së MEPTINIS, të dt. 17.03.202, për Kom. Elektronike dhe Postare.
62	Programimi kompjuterik, konsultimi dhe veprimtaritë e tjera rreth tij.	PO	
63	Veprimtaritë e shërbimit të informacionit	PO	

64	Veprimtaritë e shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe fondeve pensionale	PO	Sqarim: Bankat, pagestarët, transferuesit e parave, këmbimoret, etj. Kërkohej shmangie maksimale e parasë së gatshme dhe zbatimi rigoroz i masave të higjienës, distancës sociale, e shmangies së kontaktit!
65	Sigurimi, risigurimi dhe financimi i fondeve të pensioneve, përjashtuar sigurimin shoqëror të detyrueshëm	PO	
66	Aktivitetet ndihmëse për shërbimet financiare dhe veprimtaritë e sigurimit	PO	
68	Veprimtaritë e patundshmërisë	PO	
69	Aktivitetet juridike dhe të kontabilitetit	PO	
70	Veprimtaritë e udhëheqjes së ndërmarrjeve dhe veprimtaritë e konsultimit	PO	
71	Veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinierisë; analizat dhe testimi teknik	PO	
72	Hulumtimet shkencore dhe zhvillimi	PO	
73	Publiciteti dhe hulumtimi i tregut	PO	
74	Aktivitetet të tjera profesionale, shkencore dhe teknike	PO	
75	Veprimtaritë e veterinarisë	PO	
77	Veprimtaritë e qiradhënies dhe të lizingut	PO	
78	Veprimtaritë e punësimit	PO	
79	Agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe shërbimet e rezervimeve të tjera dhe veprimtaritë lidhur me to	PO	
80	Veprimtaritë e sigurisë dhe të hetimit	PO	
81	Shërbimet ndaj ndërtesave dhe shesheve	PO	
82	Administrimi i zyrave, mbështetja administrative dhe veprimtaritë e tjera mbështetëse të bizneseve	PO	
84	Administrata publike dhe e mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	PO	



PH

85	Arsimi	JO	PËRVEÇ formave nga largësia me anë të TV, internet, dmth pa prezencë të nxënësve dhe mësimit në dhomë të mësimit.
86	Veprimtaritë e shëndetit të njeriut	PO	
87	Veprimtaritë e përkujdesjes në shtëpi	PO	
88	Veprimtaritë e kujdesit social pa akomodim	PO	
90	Veprimtaritë krijuese, artistike dhe argëtuese	JO	
91	Bibliotekat, arkivat, muzetë dhe veprimtaritë e tjera kulturore	JO	
92	Veprimtaritë e lojërave të fatit dhe basteve	JO	
93	Veprimtaritë sportive, argëtuese dhe veprimtaritë e rekreacionit	JO	
94	Aktivitetet e shoqatave dhe organizatave	PO	Qartësim: pa grumbullim të anëtarësisë.
95	Riparimi i kompjuterëve dhe artikujve të tjerë personal dhe shtëpiakë	PO	Qartësim: Komunikimi me klientin, duke mbajtur distancën shoqërore e shmangien e kontaktit.
96	Veprimtaritë e tjera shërbyese	JO	Të gjitha veprimtaritë e kësaj kategorie, me përjashtim të n/kategorive: 96.01, 96.03
96.01	Larja (pastrimi kimik) dhe tharja e tekstileve dhe produkteve të gëzofit	PO	
96.03	Shërbimet funerale dhe veprimtaritë e lidhura me to	PO	
97	Veprimtaritë e ekonomive familjare si punëdhënës të personelit vendor	PO	
98	Aktivitetet e prodhimit të mallrave e shërbimeve të ndryshme të familjeve për përdorim vetanak	PO	
99	Veprimtaritë e trupave dhe organizatave ndërkombëtare	PO	

*Në faqen e ARBK: <https://arbk.rks-gov.net/>
<https://arbk.rks-gov.net/desk/inc/media/4E4C1941-A8CA-4A67-AF02-BFCCAA891E42.pdf>